



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2023:218671

Datë: 18.12.2023

Numri i dokumentit: 05084740

PPP.nr.15A/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË FUSHË KOSOVË, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Freskim Musliu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorës A . K . B . , të cilën e përfaqëson av. V. H. nga Prishtina, ndaj debitorit Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.263/23, të datës 28.09.2023, të Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina, jashtë seance, me datë 18.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Fushë Kosovës, i paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.263/23, të datës 28.09.2023, të Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina.
- II. SHFUQIZOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.263/23, i datës 28.09.2023, i Përmbartuesit Privat E . M . nga Prishtina.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.263/23, me datë 28.09.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të titullit ekzekutiv Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2389/21, të datës 30.10.2022, me të cilin e ka detyruar debitorin Komunën e Fushë Kosovës që kreditorit t'ia shumën e përgjithshme prej 248 euro (dyqindedyzetetë euro), me kamatë ligjore prej 8 % në vit, nga data 25.05.2021 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore aq sa do të arrihen deri në përfundim të procedurës

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, për shkak se sipas debitorit urdhri përmbartimor është përsëritur te po e njëjta zyre përmbartimore. Tutje shton se që të mos përsëritet gabimi ngase kanë vërejtje nga auditorët për realizimin e dyfishta të aktgjykimeve, obligohen të bëjnë prapësim, me të cilin kanë kërkuar nga

gjykata që ta refuzojë urdhrin përmbarrimor dhe këtë shprehë të kreditorëve që të ndajnë lëndët në disa procedura përmbarrimore, ngase do të ketë keqpërdorim të parasë publike si dhe do të kenë ngatërresë në drejtorinë e financave dhe Thesarin e Kosovës, sepse evidentohet vetëm një aktgjykim dhe numër i tij.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se kreditori ka iniciuar propozim për përmbarrim tek përmbarruesi privat vetëm për shpenzimet e procedurës kontestimore që janë vendosur me këtë aktgjykim, ndërsa për borxhin kryesor ka iniciuar procedurën përmbarrimore në gjykatë. Tutje ka shtuar se me datë 28.08.2023 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118, i cili ka hyrë në fuqi me 28.08.2023, apo 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare, i cili ka paraparë që *“7. Përmbarruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbarrimit dhe zbatimin e përmbarrimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës”*. Tutje ka shtuar se duke pasur parasysh këtë fakt juridik, kreditorja ka tërhequr propozimin për përmbarrim për borxhin kryesor të parashtruar në gjykatë dhe ka iniciuar procedurën përmbarrimore tek përmbarruesi privat në përputhje me dispozitën ligjore të cekur sipër, duke kërkuar kompensimin edhe për borxhin kryesor, e cila procedurë përmbarrimore zhvillohet sipas këtij numri, e tani e tutje, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore më sipër, nuk ka asnjë arsye që këto procedura të ndahen, sepse kompetencë ka vetëm përmbarruesi privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me nenin 21 të LPP-së parashihet se *“Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*. Ndërsa, sipas nenit 22, parag. 1, nënparag. 1.2, si dokument përmbarrimor është vendimi përmbarrues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbarruese.

Me nenin 36 të LPP-së parashihet se *“Së bashku me propozimin për përmbarrim, organit përmbarrues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarrues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarrueshmëris për përmbarrueshmëri”*.

Gjykata, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe duke ju referuar dispozitës së cekur më lart, gjeti se dokumenti përmbarrimor, përkatësisht aktgjykimi mbi bazën e së cilit është paraqitur propozimi për përmbarrim dhe është lëshuar urdhri përmbarrimor, nuk është bashkëngjitur në origjinal apo kopje të vërtetuar, siç kërkohet me nenin 36 të LPP-së. Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbarrim mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhri, përmban të meta, ngase propozimit për përmbarrim nuk i është bashkëngjitur dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar mbi bazën e së cilit është iniciuar procedura përmbarrimore, ashtu siç përcaktohet edhe me dispozitën nga neni 38, parag. 1 të LPP-së, me të cilën parashihet se

propozimi për përmbarrim, ndër të tjera, duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarrim në të cilën do të tregohet, dokumenti përmbarrimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm.

Në anë tjetër, sipas nenit 43, parag. 4 të LPP-së, përcaktohet se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Andaj gjykata, duke ju referuar dispozitave të sipër cekura, gjen se në rastin konkret urdhri përmbarrimor është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lëshimin e tij, ngase propozimit për përmbarrim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit – aktgjykimit, dhe si i tillë ka përmbajtur të meta në kuptim të nenit 38, parag. 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen, ngase këto të meta kanë mundur të trajtohet nga organi përmbarrues, përkatësisht nga përmbarruesi privat dhe atë para lëshimit të urdhrin, në kuptim të nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarrim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarrues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*.

Nga të lartcekurat, gjykata në bazë të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË FUSHË KOSOVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
PPP.nr.15A/23, me datë 18.12.2023.

Gjyqtari

Freskim Musliu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.